



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 4 dhe 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës 1Nr.400-18977 të datës 12.04.2021 të Bashkësisë Islame dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1500€ (njëmijë e pesqindë euro), sipas kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan, për të mbështetur financiarisht në kompanjën "Sofra e Ramazanit" për t'iu dalur në ndihmë familjëve në nevojë me artikuj ushqimor për muajin e shenjtë të Ramazanit.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Bashkësisë Islame në nr. 17192000190037882 në NLB Bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara të lartëcekura duhet të sjell raportë dhe dëshmi-faturë deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore më së largu me datë 08.06.2021.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet BIK-u dega në Lipjani.

1Nr.400-18977

Lipjan, më 13.04.2021

